



Funded by
the European Union

Lëvizja LGBTI+ në Kosovë Qasjet dhe Praktikrat e Ndërthurjes për Drejtësi Sociale

2024

Implementuar nga:



QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETET LGBT NË KOSOVË (CEL)

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESE E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

CEL. Tel: +383 49 701 499
e-mail: info@cel-ks.org
web-page: www.cel-ks.org

Klauzola e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga Bashkimi Europian. Përmbatja e tij është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Lëvizja LGBTI+ në Kosovë Qasjet dhe
Praktikat e Ndërthurjes për Drejtësi Sociale

Hulumtues

Andi Vllasolli dhe Ardea Gojnovci

Mentore

Prof. Asoc. Dr. Vjollca Krasniqi

Universiteti i Prishtinës,
Fakulteti Filozofik,
Departamenti i Sociologjisë dhe Punës Sociale.
dhjetor, 2024

Falënderimet

Ky hulumtim është rezultat i një bashkëpunimi të suksesshëm dhe mbështetje të vazhdueshme nga individë dhe organizata, dhe pa kontributin e tyre ky projekt do të ishte i pamundur. Fillimisht, dëshirojmë të falënderojmë Centre for Equality and Liberty (CEL) për mundësinë dhe mbështetjen gjatë realizimit të këtij hulumtimi. Po ashtu, një faleminderim i veçantë shkon për Universitetin e Prishtinës dhe mentoren tonë, Prof. Asoc. Dr. Vjollca Krasniqi, për udhëzim dhe mbështetje të pakursyer gjatë punës në këtë projekt hulumtues. Përkushtimi dhe ndihma e juaj në çdo hap të projektit kanë qenë thelbësore për realizimin e tij.

Gjithashtu, falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit e hulumtimit për kontributin e tyre të çmuar. Ndarja e njohurive, përvojave dhe perspektivave të tyre ka pasuruar këtë punim dhe ka ofruar një kuptim më të thellë dhe më të gjerë të temës që kemi trajtuar. Pa angazhimin dhe mbështetjen tuaj, ky hulumtim nuk do të kishte arritur të realizonte qëllimet e tij. Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë ata që kontribuan me ide, sugjerime dhe material të nevojshëm, duke bërë të mundur përfundimin e këtij projekti. Ju falënderojmë të gjithëve për angazhimin dhe përkushtimin tuaj në mbrojtjen të drejtat e njeriut dhe drejtësinë shoqërore.

Përmbajtja

• Falënderim	4
• Lista e shkrutesave	6
• Abstrakti	7
• Hyrje	8
• Lëvizja LGBTI+ në Kosovë: Qasjet dhe Praktikave të Ndërthurjes për Drejtësi Sociale ..	9
• Metodologjia	16
• Etika dhe Pozicionaliteti	17
• Ndërthurja: Bazë e Misionit dhe Praktikave të Lëvizjes LGBTI+ në Zhvillim	19
Aktivizmi dhe Fuqizimi i komuniteteve LGBTI+ përmes Qasjes Ndërthurëse	22
Sfidat dhe Tejkalmimi përmes Vëmendjes ndaj Ndërthurjes dhe Përfshirjes	23
• Kufizimet e Hulumtimit	27
• Përfundimet	28
• Referencat	29
• Shtojcat	32
• Pyetësi #1 Për aktivistët e organizatave LGTBI+	32
• Pyetësi #2 Për pjesëtarë të komuniteteve queer	34
• Formulari për Pëlqimin e Informuar	37

Lista e shkrutesave

CEL - Center for Equality and Liberty (Qendra për Barazi dhe Liri)

CSGD - Center for Social Group Development (Qendra për Zhvillim të Komuniteteve)

LGBTI+ - Lesbike, Gej, Biseksualë, Transgjjinorë, Interseksualë

OJQ - Organizatë jo-qeveritare

Abstrakti

Hulumtimi “Lëvizja LGBTI+ në Kosovë: Qasjet dhe Praktikrat e Ndërthurjes për Drejtësi Sociale” për fokus ka shqyrtimin dhe analizën e mënyrës se si komunitetet LGBTI+ në Kosovë adopton qasjen gjinore dhe ndërthurëse në aspekte si aktivizmi, avokimi dhe ofrimi i shërbimeve për personat LGBTI+. Hulumtimi e analizon reprezentimin si dhe përfshirjen e komuniteteve LGBTI+ në proceset si avokimi, duke i vlerësuar nevojat dhe kërkesat e individëve LGBTI+ dhe si janë adresuar ato në një nivel institucional dhe ligjor. Po ashtu, hulumtimi shqyrton ndikimin e qasjeve në forcimin e dukshmërisë dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve LGBTI+ në Kosovë, duke identifikuar sfidat dhe mundësitë për avansimin e drejtësisë dhe barazisë sociale për këtë grup shoqëror. Duke përdorur qasje kualitative, janë realizuar intervista të thella me aktivistë dhe anëtarë të komuniteteve LGBTI+ për të kuptuar përvojat e tyre dhe sfidat me të cilat përballen. Rezultatet tregojnë se, ndërthurja e faktorëve socialë dhe kulturorë kanë një rol shumë të rëndësishëm në formësimin e strategjive dhe veprimeve të lëvizjes. Hulumtimi thekson rëndësinë e ndërgjegjësimit dhe edukimit si mjete kryesore për përmirësimin e të drejtave dhe kushteve të komuniteteve LGBTI+, si dhe ofrimin e shërbimeve ligjore dhe sociale, për mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe barazisë sociale.

Fjalët kyçe: lëvizja LGBTI+; ndërthurja; diversiteti; përfshirja; drejtësia sociale

Hyrje

Lëvizja LGBTI+ në Kosovë është organizim që në vitet e fundit, është bërë gjithnjë e më i zëshëm, gjithmonë duke reflektuar përpjektjet për barazi dhe drejtësi sociale. Në Kosovë, nga fillimi i viteve 2000 e tutje, shihen përpjekje më të dukshme të Lëvizjes LGBTI+, me fillimin e themelimit të organizatave jo-qeveritare (OJQ). Organizatat si Centre for Equality and Liberty (CEL), Center for Social Group Development (CSGD), Sekhmet, Hyjneshat etj, në mënyra të ndryshme, ngrisin zërat, mbështesin personat dhe vazhdimisht të krijojnë hapësira emancipuese për të drejtat e njerëzve të komuniteteve LGBTI+ (Cakolli & Nokaj, 2024). Lëvizja LGBTI+ në Kosovë, ka arritur që të krijojë platformë për personat LGBTI+, në aspekte të ndryshme si mbështetja emocionale, psikologjike, avokimit dhe krijimit të hapësirave emancipuese. Gjatë shtrirjes gjithëherë e më shumë të lëvizjes, komunitetet jo shumicë si ata Romë, Ashkali, Egjiptianë, kanë qenë vazhdimisht të shtypur nga stigma e dyfishtë për identitetin e tyre etnik dhe qenurit queer, pra përcaktim gjinor dhe orientimin seksual të ndryshëm, ku kjo rezulton me shtypje të dyfishtë, brenda dhe jashtë komunitetit të tyre (Fremlova, 2020). Shtypja së dyfishtë ka një ndikim të madh si në aspektin psikologjik ashtu edhe në atë social.

Hulumtimi është shumë i rëndësishëm nga disa arsye kyçe. Fillimisht, ky hulumtim ndihmon në dokumentimin dhe kuptimin e përvojave specifike të komuniteteve që përballen me stigma të shumëfishtë, duke përfshirë edhe elementet e ndërthurjes të identifikuar nga Kimberly Crenshaw (1989). Koncept i ndërthurjes ndihmon në kuptimin e mënyrave se si diskriminimi po në këtë rast edhe shtypja e shumëfishtë

ndërveprojnë në përkeqësimin e përvojave të individëve, në veçanti individëve që janë nga një grup i marginalizuar. Duke u ndërlidh me këtë, së dyti, ky hulumtim siguron një bazë për zhvillimin e strategjive si dhe ndërhyrjen specifike për adresimin e shtypjeve të shumëfishta, duke kuptuar më mirë nevojat specifike të komuniteteve të marginalizuara, ku organizatat dhe institucionet mund të ofrojnë një mbështetje më të përshtatshme dhe më efektive.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të analizojë se si Lëvizja LGBTI+ në Kosovë e adopton qasjen gjinore dhe ndërthurëse në aktivizëm, avokim si dhe ofrimin e shërbimeve për individët. Por si qëllim tjetër është shqyrtimi i perceptimeve dhe ndjesive të komuniteteve LGBTI+ lidhur me reprezentimin dhe përfshirjen e tyre në këto procese si avokimi dhe praktikrat e parashtrimit të kërkesave. Punimi është i organizuar përmes këtyre kapitujve: shqyrtimi i literaturës, metodologjia dhe çështjet etike, rezultatet dhe diskutimet, si dhe përfundimi.

Lëvizja LGBTI+ në Kosovë: Qasjet dhe Praktikrat e Ndërthurjes për Drejtësi Sociale

Lëvizja LGBTI+ në Kosovë përballet me një kompleksitet sfidash që lidhen me shtypjen sociale dhe diskriminimin, duke kërkuar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe ndërthurëse në

aktivizmin dhe avokimin e saj. Shtypja ndaj individëve LGBTI+ shfaqet në forma të ndryshme, dhe për të arritur drejtësi sociale, është e nevojshme që komunitetet e cenuara të bashkëpunojnë në të gjitha fushat për të luftuar normat dhe strukturat shtypëse (Cumming-Potvin, 2023). Individët LGBTI+ preken nga “Korniza e Dominimit” ku shumë persona LGBTI+ mund të preken nga strukturat shtypëse si patriarkati, homofobia, transfobia, bifobia, racizmi, klasicizmi, ku tërë këto formësojnë realitetin social të një individi dhe grupi shoqëror (Ferber, O'Reilly Herrera, & Samuels, 2007).

Qasja ndërthurëe është thelbësore për të siguruar që çdo individ të ndjehet i përfshirë dhe i përfaqësuar. Studimet tregojnë se individët me identitete të shumta të shtypura përballen me forma më të rënda të diskriminimit (Adams, 2016). Kjo është e rëndësishme në kontekstin e Kosovës, ku 67% e personave LGBTI+ kanë raportuar se kanë përjetuar diskriminim për shkak të orientimit të tyre seksual (CSGD, 2016). Kjo situatë tregon nevojën për një qasje të integruar që adreson jo vetëm çështjet e orientimit seksual, por edhe ato të identitetit gjinor, ‘racës’, dhe klasës. Megjithatë, për të arritur një sukses të vërtetë, qasja e ndërthurjes duhet të zgjerohet përtej identiteteve tradicionale binare, duke përfshirë dhe aspekte të tjera të shtypjes (Adams, 2016). Kjo është thelbësore, pasi stereotipet tradicionale që krijojnë një dikotomi ndërmjet heteroseksualizmit nuk ofrojnë hapësirë për identitete më fluide (Cumming-Potvin, 2023). Kështu, aktivizmi duhet të përqendrohet në promovimin e diversitetit dhe respektimin e të gjitha identiteteve, duke ndihmuar në minimizimin e stigmatizimit dhe ndarjeve brenda komuniteteve. Një shembull i rëndësishëm i këtij aktivizmi është Parada e Krenarisë, e cila, sipas 71% të anketuarve, ka kontribuar në vetëdijësimin e publikut (CSGD, 2016).

Megjithatë, aktivizmi ndodhet përballë sfidave të vazhdueshme, përfshirë frikën nga homofobia, transfobia dhe bifobia, të cilat janë të pranishme në shoqërinë patriarkale dhe konservatore të Kosovës. Shumë individë ende ndihen të detyruar të maskojnë identitetin e tyre për shkak të këtyre frikave, veçanërisht në ngjarje publike si paradat (Limani, 2022). Mungesa e përvojës historike të aktivizmit LGBTI+ në Kosovë gjithashtu ka një ndikim shumë të madh. Aktivizimi i hershëm shpesh zhvillohej në hije, me organizata që vepronin në mënyrë jo-formale dhe shpesh në kushte të rrezikshme (Limani, 2022). Gjatë asaj kohe, individët LGBTI+ ishin më të cenuar dhe përballeshin me pengesa të shumta për mobilizim.

Është e rëndësishme të njihet se brezat e rinj kanë më shumë mundësi për aktivizëm falë zhvillimeve në teknologji dhe rrjete sociale. Pavarësisht përparimeve të arritura, siç janë përmirësimet në kornizën ligjore për mbrojtjen ndaj diskriminimit, realiteti për individët LGBTI+ në Kosovë mbetet sfidues (Limani, 2022). Studimet tregojnë se 81% e anketuarve kanë përjetuar sulme verbale, ndërsa 29% kanë përjetuar abuzim fizik (CSGD, 2016). Të dhënat sipas një studimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sugjerojnë se aktivizmi i komuniteti LGBTI+ mund të ketë ndikim edhe në nivel shtetëror. Sipas të njëjtit studim, aktivizmi mundëson individët që të përballojnë stigmën. Këto të dhëna përfaqësojnë një nevojë urgjente për angazhim dhe aktivizëm që të trajtojë këto çështje dhe të promovojë një shoqëri më të drejtë dhe më gjithëpërfshirëse (Schealder, 2022).

Lëvizja LGBTI+ në Kosovë ka potencial të adoptojë qasje më të thella dhe ndërthurëse në aktivizmin dhe avokimin e saj, duke kontribuar kështu në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë për të gjithë. Pyetjet hulumtuese që shqyrtojmë do të

ndihmojnë në perceptimin dhe përvojat te komuniteteve LGBTI+ lidhur me përfshirjen dhe përfaqësimin në kërkesat për drejtësi sociale. Ndërthurja, si qasje analitike, shpesh kritikohet për theksimin e saj në aspekte përshkruese, me një dimension dekonstruktiv për të përballuar sfidat e ndryshme të shtypjes (Adams, 2016). Kjo qasje është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e aktivizmit LGBTI+, ku realiteti përfaqësohet shpesh në mënyra që përjashtojnë individë me identitete të shumta. Për shembull ndarja ndërmjet cis-burrave gej të bardhë dhe grupeve të tjera brenda lëvizjes krijon një dinamikë të dominimit dhe marginalizimit (Rexhepi, 2016).

Politikat e Bashkimit Evropian kanë ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në formësimin e perceptimeve rreth komuniteteve LGBTI+. Homonacionalizmi është një dukuri aktuale në relacion me qëndrimet anti-emigrante e nacionaliste. Personat LGBTI+ janë ndikuar nga këto fenomene dhe e bëjnë lidhje ndërmjet performimit të gjinisë së tyre duke u përshtatur me interesin kombëtar (Puar, 2007). Kjo qasje e imponuar e sjell ndarjen në perspektiva progresive dhe tradicionale, duke theksuar se lëvizjet LGBTI+ mund të ndihen të detyruara të përqafojnë një narrativë që nuk përfshin realitetet e plota të përvojave të tyre.

Një problem tjetër është se qasjet "problematike" që fokusohen vetëm në zgjidhjen e një problemi të vetëm shpesh injorojnë ndërthurjen e marginalizimit dhe shtypjes. Kjo krijon një ndarja në "ata dhe ne", ku probleme të tjera shoqërore, si racizmi dhe klasicizmi, mbesin të anashkaluara (Davis & Zarkov, 2017). Racizmi seksual është një tjetër çështje që përballet komuniteteve LGBTI+. Sipas një hulumtimi në ShBA, cis-burrat e bardhë kanë tendencë më të lartë të specifikojnë 'racën' e preferuar në rrjete online. Në anën tjetër,

sipas hulumtimit të njëjtë 20.6% e martesave të personave të gjinisë së njëjtë në Amerikë janë ndër 'racore', e cila është shumë e lartë se martesat e personave të gjinisë së ndryshme. Në martesat e burrave homoseksual, ende është prezente përdorimi i një gjuhe raciste dhe kategorizimi i kërkesës së partnerit sipas racës, ku ky kategorizim bëhet duke përdorur kategori përshkruese, si "i zi – çokollatë", "aziatik – oriz", etj. Kjo tregon se për të përballuar sfidat e shtypjes, është e domosdoshme të kemi një qasje të integruar që trajton të gjitha dimensionet e identitetit dhe diskriminimit. (Robinson & Frost, 2018).

Ndërthurja, si koncept analitik, ndihmon në zbërthimin e strukturave të ndryshme të diskriminimit që ndodhin në kontekste të ndryshme. Ajo promovon një kuptim më të thellë se si identitetet e ndryshme ndikojnë në qasjen e individëve në të drejtat dhe burime. Kjo qasje është esenciale për të kuptuar kompleksitetin e përvojave të personave LGBTI+ dhe për të zhvilluar strategji avokimi më efikase (D'Elío, 2015). Të drejtat e personave LGBTI+ nuk mund të trajtohen në izolim nga të drejtat e grupeve të tjera të margjinalizuara, si gratë, fëmijët, dhe individët me aftësi të kufizuara. Çdo përvojë është unike dhe e ndikuar nga shumë faktorë, përfshirë racën, klasën, dhe statusin socio-ekonomik. Kjo ndihmon në theksimin e nevojës për qasje të reja dhe më të ndryshme për avokimin e të drejtave të njeriut (Crenshaw, 1989). Koncepti i ndërthurjes ofron një mjet të rëndësishëm për të kuptuar dhe analizuar dinamikat komplekse të identiteteve dhe diskriminimit brenda lëvizjes LGBTI+. Kjo qasje ndihmon në sfidimin e strukturave të pushtetit dhe diskriminimit që shpesh janë të padukshme, duke kontribuar kështu në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë. Historia e komunitetit romë në Kosovë është e shënuar nga episode të shumta shtypjeje dhe diskriminimi. Një nga

momentet më të rënda ishte Lufta e Dytë Botërore, kur shumë romë u masakruan dhe torturuan nga forcat naziste, duke përjetuar dhunë të paimagjinueshme (Chiriac et al., 2022). Kjo trashëgimi dhune vazhdon të ndikojë negativisht në jetët e romëve sot, duke u reflektuar në nivele të ulëta të arsimimit dhe punësimit. Megjithëse, shumë fëmijë romë janë të regjistruar në arsimin e detyrueshëm, ata përballen me një hendek të dukshëm në krahasim me fëmijët jo-romë, me vetëm 60% të rinjve romë që përfundojnë arsimin e detyrueshëm (Stanko, 2021). Ky hendek është më i theksuar për gratë rome, duke krijuar një pabarazi gjinore që thekson sfidat strukturore me të cilat ata përballen. Në nivelin e punësimit, normat janë gjithashtu alarmante; vetëm 13% e romëve janë të punësuar, dhe gratë rome kanë një shkallë pjesëmarrjeje në fuqinë punëtore prej vetëm 10% (Stanko, 2021). Kjo situatë e vështirë përforcohet nga punësimi joformal, i cili është shumë i përhapur.

Për më tepër, qasjet esencjaliste dhe konstruktiviste nuk janë të mjaftueshme për të përshkruar identitetin romë. Teoria queer argumenton se identiteti romë është i ndryshueshëm dhe i varur nga konteksti social, duke e bërë të pamundur përgjithësimin e përvojave të këtij komuniteti (Fremlova, 2020). Ky fluiditet në identitet është thelbësorë për të kuptuar se si romët përjetojnë diskriminimin, duke përfshirë racizmin që ndodh brenda komuniteteve LGBTI+. Pjesëmarrësit në studime kanë raportuar se, si individë romë, përballen me paragjykitime dhe stigmatizim, përfshirë pyetje të drejtpërdrejta si "A të vjen marrë se je romë?" (Fremlova, 2020). Kjo situatë thekson nevojën për një qasje ndëthurëse në aktivizmin për të drejtat e njeriut, që përfshin jo vetëm identitetin seksual, por edhe identitetin etnik dhe gjininë. Është e rëndësishme të kuptohet se shtypja dhe diskriminimi janë të ndërlidhura dhe se individët me identitete të shumta

përballen me sfida të veçanta që kërkojnë zgjidhje të integruara. Gjithashtu, Judith Butler (1999) na kujton, konceptet e gjinisë dhe seksit janë krijime kulturore që nuk mund të kuptohen si kategori të veçanta dhe natyrore. Individët LGBTI+ shpesh përballen me norma kulturore që përcaktojnë se si duhet të jenë identitetet dhe rolet gjinore, dhe kjo mund të çojë në diskriminim.

Aktivizmi LGBTI+ ka një rol të rëndësishëm në sfidimin e këtyre normave dhe krijimin e një shoqërie që pranon diversitetin. Në Kosovë, lëvizja LGBTI+ ka mundësinë të kontribuojë në një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë, ku të drejtat e të gjithëve respektohen dhe mbrohen. Ky angazhim mund të çojë në një shoqëri ku të gjithë ndjehen të vlerësuar, të barabartë, dhe të sigurtë.

Metodologjia

Hulumtimi bazohet në metodologji kualitative të dyfishtë, e para konstituon në intervista gjysmë të strukturuar dhe e dyta, në analizën e përmbajtjes. Me këtë qasje metodologjike synohet të kuptojmë se si organizatat queer në Kosovë adaptojnë perspektivën e ndërthurjes dhe, njëkohësisht, se si personat queer ndihen të përfshirë dhe të përfaqësuar në lëvizje. Në hulumtim janë realizuar gjithsej pesë (5) intervista, ku dy (2) prej tyre kanë qenë me aktivistë të organizatave queer dhe tre (3) me persona queer. Mostra është përzgjedhur përmes teknikës snow-ball [topi i borës], të zhvilluara ballë-për-ballë. Në përgjithësi, intervistat kanë zgjatur 30–40 minuta, me pyetje të hapura rreth temës së hulumtimit. Për këtë qëllim, janë përpiluar dy pyetësorë të veçantë: një për aktivistët dhe një për personat queer, që i përkasin edhe komuniteteve të tjera, të cenuara. Analiza e përmbajtjes është kryer në formë deduktive, duke përdorur një kornizë teorike dhe kode të parapërcaktuara, si për shembull: gjithëpërfshirje, statusi socio-ekonomik, etnia, mosha, dhe vendbanimi. Analiza është fokusuar në raportet vjetore të dy organizatave queer gjatë viteve 2016–2023. Raportet janë gjetur në faqet zyrtare të organizatave dhe gjatë analizës jemi përqendruar në strategjitë, fushatat dhe programet e tyre (shihni Tabelën 1). Këto kode ndihmuan të kuptojmë strategjitë, politikat dhe fushatat e organizatave queer, dhe evoluimin e tyre ndër vite në aplikimin e qasjes ndërthurëse.

Etika dhe Pozicionaliteti

Ky hulumtim është realizuar në përputhje me Kodin e Praktikës së Etikës së Kërkimit të Fakultetit Filozofik, Universiteti i Prishtinës. Udhëzimet dhe parimet e përcaktuara në këtë kod kanë udhëhequr të gjitha fazat e procesit kërkimor, duke përfshirë projektimin, mbledhjen e të dhënave, analizën dhe reprezentimin e gjetjeve. Ky hulumtim ka për qëllim të analizojë dhe të dokumentojë qasjet dhe praktikat e ndërthurjes të përdorura nga lëvizja LGBTI+ në Kosovë për promovimin e drejtësisë sociale. Të dhënat e mbledhura analizohen dhe raportohen, në mënyrë anonime duke ruajtur identitetin e individëve pjesëmarrës, duke siguruar privatësinë dhe konfidencialitetin. Ne jemi të vetëdijshëm për çështjet dhe dilemat etike që mund të shfaqen gjatë dhe pas hulumtimit tonë, si mbrojtja e të dhënave, siguria e pjesëmarrësve, rreziku i stigmatizimit dhe diskriminimit, ndjeshmëria e informacionit dhe ndikimi në dhe për komunitet. Për t'u siguruar që këto çështje janë adresuar në mënyrë adekuate, janë ndërmarrë këto hapa specifikë si, anonimizimi dhe sigurimi i konfidencialitetit, ku të dhënat trajtohen në mënyrë anonime dhe konfidenciale, si dhe identitetet e pjesëmarrësve nuk janë përdorur në raportim, por janë përdorur kode në referimin e tyre në tekst.

Pjesëmarrja ka qenë plotësisht vullnetare, me informacion të plotë të ofruar dhe mundësi të tërhiqen nga hulumtimi në çdo moment. Intervistat të cilat janë mbajtur janë regjistruar vetëm me miratimin e individëve dhe përdoren vetëm për këtë hulumtim, ndërsa tek pyetësorët dhe transkriptimet të dhënat si emri dhe mbiemri janë anonimizuar. Të gjitha këto të dhëna do të ruhen në përputhje me standardet mbrojtëse të etikës, pra duke mbetur

konfidenciale dhe duke ruajtur privatësinë dhe anonimitetin e individëve pjesëmarrës në hulumtim.

Hulumtimi synon të analizojë qasjen gjinore dhe ndërthurëse që përdoret në aktivizëm, avokim dhe në ofrimin e shërbimeve për individët LGBTI+ në Kosovë. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të reflektojmë mbi pozicionin tonë si hulumtues. Si dy studentë të orientuar nga shkencat sociale, ne vijmë nga identitete dhe përkatësi të ndryshme gjinore dhe shoqërore. Si studente e Punës Sociale, njëra studjuese sjell përvojën e saj në punën me komunitetet dhe grupet e marginalizuara, ndërsa si student i Sociologjisë, sjell një perspektivë analitike mbi strukturat dhe dinamikat sociale. Përvojat tona personale dhe profesionale në aktivizëm dhe avokim për të drejtat e njeriut kanë formësuar qasjen tonë ndaj këtij hulumtimi. Një nga motivet kryesore për këtë hulumtim është angazhimi ynë për drejtësi sociale dhe barazi.

Pozicioni ynë profesional dhe aktivist, na ndihmon të kuptojmë dhe të jemi të ndjeshëm ndaj sfidave me të cilat përballen individët LGBTI+ në Kosovë, dhe në të njëjtën kohë të reflektojmë mbi ndikimin e përvojave dhe qasjes sonë në analizën e rezultateve të hulumtimit. Angazhimi ynë për drejtësi sociale dhe barazi na motivon që ky studim të jetë gjithëpërfshirës dhe të pasqyrojë në përvojat dhe sfidat e diversitetit të komuniteteve LGBTI+ në Kosovë. Në aspektin personal, të dy jemi individë heteroseksualë, dhe kjo na jep një perspektivë unike për të reflektuar mbi përvojat tona dhe ndjeshmërinë ndaj sfidave që përballen personat LGBTI+. Si individë që nuk përjetojmë të njëjtat diskriminime, jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë për të vepruar me ndjeshmëri dhe për të mbështetur aktivisht të drejtat dhe barazinë për të gjithë. Si aleatë, dëgjojmë me vëmendje dhe mësojmë nga përvojat e komuniteteve LGBTI+, duke përdorur mundësitë tona për të mbështetur të drejtat e tyre. Hulumtimi

ynë synon të adresojë sfidat përmes një analize gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh diversitetin e identiteteve dhe respektuar dinjitetin njerëzor. Ne synojmë që ky studim të ndihmojë në krijimin e një shoqërie ku të gjithë individët mund të jetojnë të lirë dhe pa diskriminim, duke promovuar një kulturë të mirëkuptimit, dhe drejtësisë sociale.

Ndërthurja: Bazë e Misionit dhe Praktikave të Lëvizjes LGBTI+ në Zhvillim

Organizatrat queer e mishërojnë thjerrëzën e ndërthurjes në strategjitë, fushatat dhe programet e tyre. Në vitin 2017, raportet tregojnë se janë ndërmarrë iniciativa për gjithëpërfshirje në vende të ndryshme. Për shembull, në një raport të vitit 2017 theksohet: “Trajnime për nxënësit e shkollave të mesme në shtatë (7) komuna, të cilat kishin për qëllim të ofrojnë informacion mbi çështjet dhe të drejtat LGBTI+, në mënyrë që ata të mund të veprojnë si trajnerë dhe të zgjerojnë lëvizjen LGBTI+ përtej kryeqytetit.” Kjo tregon përpjekjet për të decentralizuar lëvizjen dhe për të ndërgjegjësuar të rinjtë në rajone. Në vitin 2018, fokusi u zhvendos drejt fuqizimit të të rinjëve queer. Raportet e këtij viti përmendin trajnime të cilat, përveç personave queer, përfshijnë edhe bashkëpunime me gjyqtarë dhe policë. Po

ashtu, vihet re një përqendrim në ndihmën në shëndetin mendor të komuniteteve.

Në vitet 2016–2018, strategjitë dhe fushatat theksonin përmirësimin e legjislacionit dhe mbështetjen institucionale, ndërsa perspektiva ndërthurjes ishte më pak e pranishme. Pas vitit 2019, raportet pasqyrojnë përfshirje të kategorive të reja si: çështjet e strehimit, të drejtat e minoriteteve queer dhe shëndeti mendor. Gjithashtu, vihet re një rritje e rëndësisë së dhënë të drejtave të romëve queer, duke reflektuar një qasje më të ndërthurur dhe gjithëpërfshirëse. Një gjë që e shohim që përsëritet shpesh është ndihma dhe mbështetja psikologjike. Në vitin 2023, një kategori e re që vihet re në raport është mungesa e mbështetjes së fuqishme nga politika për personat queer, përfshirë edhe gjuhën homofobike nga politikanët. Ky është një zhvillim interesant dhe shqetësues, pasi sugjeron që, edhe pse mbështetja institucionale për personat queer mund të ketë përparuar në disa aspekte, politikat publike dhe përfaqësimi politik mbesin pika të dobëta. Nga ana tjetër, në raport gjithashtu përmendet se ka disa përmirësime në mbështetjen për personat queer, edhe pse këto janë të kufizuara. Ky është një tregues që ndryshimi pozitiv është ende në fazat fillestare dhe nuk është bërë i dukshëm ose i qëndrueshëm në të gjitha nivelet e politikave publike, institucioneve, dhe shoqërisë. Mbështetja për personat queer mbetet një problem evident dhe i vazhdueshëm.

Tabela 1. Analiza e Përmbajtjes: Raportet Vjetore të Organizatave LGBTI+ në Kosovë

Raporti i Organizatave LGBTI+ në Kosovë: Viti 2016				
Patriarkati	Çështjet ligjore	Gjuha e urrejtjes	Bashkëpunim institucional	Kërcënimi me vdekje
Raporti i Organizatave LGBTI+ në Kosovë: Viti 2017				
Importimi i ligjeve	Çështjet e të drejtave të njeriut	Bashkëpunim institucional	Reprezentimi mediatik	Gjithëpërfshirja gjeografike
Raporti i Organizatave LGBTI+ në Kosovë: Viti 2018				
Trajnime për policë si dhe gjykatës	Fuqizimi i të rinjëve queer	Ligjet heteronormative	Kodi Civil	Mbështetja psikologjike
Raporti i Organizatave LGBTI+ në Kosovë: Viti 2019				
Strehimorja	Emancipimi i rinisë queer	Shëndeti mendor	Sulmet ndaj personave queer	Të drejtat e minoriteteve
Raporti i Organizatave LGBTI+ në Kosovë: Viti 2021				
Ndihma Juridike	Orientimet Seksuale	Strehimorja	Mbështetja ndaj Romëve	Hartimi i Kodit Civil
Raporti i Organizatave LGBTI+ në Kosovë: Viti 2022				
Heteronormativiteti	Mbështetja e dobët politike	Ndihmë për strehim	Keqreprezentimi mediatik	Avokimi
Raporti i Organizatave LGBTI+ në Kosovë: Viti 2023				
Shëndeti mendor	Të drejtat e grave dhe të grave trans	Mbështetje psikologjike	Çështjet ligjore	Keqreprezentimi mediatik

Aktivizmi dhe Fuqizimi i komuniteteve LGBTI+ përmes Qasjes Ndërthurëse

Intervistat janë gjysmë të strukturuar, ofruan mundësi që intervistuesi/ja të bëjë pyetje shtesë, për të thelluar kuptimin rreth ndërthurjes dhe diversitetit në lëvizjen LGBTI+. Intervista me aktivistë të organizatave dhe me persona queer, të zhvilluara me pyetësor, të veçantë, një për aktivistët dhe një tjetër për personat queer, që i përkasin edhe komuniteteve të tjera të cenuara ofruan perspektiva individuale mbi aktualitetin, hendeqet, dhe vizionin për të ardhmen e shoqërisë sipas parimeve të drejtësisë shoqërore. Intervistat shpërfaqin rëndësinë e emancipimit dhe fuqizimit të personave LGBTI+. Për më shumë, ata/ato theksojnë edhe rolin e ndihmës psiko-sociale, trajnimit për zhvillimin e aftësive menaxheriale, si dhe përdorimin e artit dhe kulturës si mjete për ngritje të vetëdijes, dhe edukimit për fuqizimin e individëve, duke krijuar hapësira dhe platforma që lejojnë shprehjen e identiteteve të tyre.

Organizatrat LGBTI+ adoptojnë qasje ndërthurëse përgjatë punës në aktivitete të ndryshme. Projektet përfshijnë një perspektivë të ndërthurjes në mënyra të ndryshme. Për shembull, një iniciativë për radio është zhvilluar për persona që jetojnë në zona rurale, duke krijuar hapësira për t'i shprehur përvojat e tyre. Po ashtu, janë përmendur ekspozita dhe programe të dedikuara për përfshirjen e personave queer nga grupe etnike jo-shumicë, si dhe projekte për zhvillimin e shkathtësive të ndryshme. Pjesëmarrja në këto programe për personat queer është falas, dhe aftësitë e fituara i ndihmojnë ata/ato për t'u integruar në tregun e punës.

Këto praktika janë të rëndësishme sepse synojnë të mbështesin personat queer që nuk gëzojnë privilegjet e njëjta si ata që jetojnë në Prishtinë, të cilët shpesh kanë qasje më të mirë, mbështetje nga rrethi social, dhe kushte më të mira ekonomike. Këto projekte synojnë të adresojnë specifikisht nevojat e personave queer nga grupe etnike, me status socio-ekonomik të ulët, dhe që jetojnë në margjina. Kjo qasje pasqyron perspektivën e ndërthurjes, e cila sugjeron se shtypja nuk mund të trajtohet vetëm nga një perspektivë e vetme. Përkundrazi, duhet të merren parasysh format e shumta të shtypjes që ndërveprojnë për të adresuar pabarazitë në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme.

Sfidat dhe Tejkalimi përmes Vëmendjes ndaj Ndërthurjes dhe Përfshirjes

Intervistat me aktivistët e dy organizatave queer në Kosovë nxjerrin në pah disa sfida kryesore që lidhen me punën dhe mbështetjen e komunitetit queer. Së pari, një sfidë e dukshme është mungesa e hapësirave të sigurta për personat queer, veçanërisht në qytetet e vogla dhe në zona rurale. Aktivistët theksojnë se individët queer që jetojnë jashtë Prishtinës kanë vështirësi në qasje në hapësira që ofrojnë mbështetje dhe aktivitete queer. Ndërkohë që Prishtina, si kryeqytet, ofron mundësi më të mëdha për komunitetet, por përpjekjet për të përfshirë individë nga qytetet më të vogla janë të kufizuara. Një tjetër sfidë ka të

bëjë me përpjekjet për gjithëpërfshirje, pasi aktivistët po përballen me vështirësi për të përfshirë grupe të tjera të cenuara brenda komunitetit queer, si individët që i përkasin grupeve etnike jo-shumicë. Kjo kërkon njohjen e gjuhëve dhe krijimin e programeve që reflektojnë diversitetin etnik dhe që mund të sigurojnë përfshirje të plotë në aktivitete.

Për më tepër, shumë aktivistë pranojnë se në fazat e hershme të lëvizjes queer në Kosovë, fokusi ka qenë në mbijetesën, jo te përfshirja e grupeve të ndryshme, si lezbiket, trans-gruaja dhe të tjera, duke lënë disa kategori jashtë angazhimeve të drejtpërdrejta. Aktivistët janë duke bërë përpjekje aktive për të zgjeruar mundësitë për qasje në informacion dhe mbështetje, përmes kanaleve të ndryshme, përfshirë radio dhe media të tjera, duke ndihmuar individët queer që jetojnë në zona më të largëta dhe që nuk mund të arrijnë në aktivitete që organizohen në qytetet e mëdha. Dy organizatat që janë pjesë e këtij hulumtimi janë gjithashtu duke punuar për krijimin e hapësirave gjithëpërfshirëse, ku jo vetëm individët nga grupe të ndryshme etnike, por edhe ata me identitete të tjera, mund të gjejnë mbështetje. Një nga organizatat thekson rëndësinë e përdorimit të gjuhëve të ndryshme për të përfshirë individët që flasin gjuhë të tjera dhe për të krijuar programe të përshtatshme për të gjithë.

Një tjetër hap pozitiv është fuqizimi socio-ekonomik, ku organizatat ofrojnë trajnime falas për të ndihmuar individët queer në autonominë e tyre ekonomike, duke mundësuar më shumë mundësi për integrimin e tyre në shoqëri. Po ashtu, rritja e vetëdijes për shëndetin mendor dhe HIV/AIDS është një hap tjetër i rëndësishëm, përmirësimi i shërbimeve psiko-sociale dhe organizimi i aktiviteteve për vetëdijësimin mbi këto çështje është një përpjekje për të përmirësuar mirëqenien emocionale dhe shëndetësore të komunitetit queer. Në përgjithësi, OJQ-të queer janë duke ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të adresuar nevojat dhe sfidat e

komuniteteve LGBTI+, edhe pse ende përballen me kufizime të lidhura me përfshirjen e të gjithë grupeve. OJQ-të që janë pjesë e intervistës kanë një fokus të qartë në krijimin e mundësive gjithëpërfshirëse, por aktivistët përballen shpesh me situata ku disa grupe të vogla dhe të veçanta kanë vështirësi për të shprehur dhe realizuar hapësira të përbashkëta.

Ky është një tension i vazhdueshëm mes nevojës për mbijetesë dhe përpjekjeve për përfshirje të plotë. Po ashtu, OJQ-të shpesh janë të angazhuara më shumë në mbijetesë dhe mbështetje, duke i dhënë prioritet nevojave të menjëhershme, si shëndeti mendor dhe mundësitë ekonomike, ndërkohë që përpjekjet për krijimin e një qasje të plotë gjithëpërfshirëse janë një proces afatgjatë dhe kërkojnë burime dhe angazhim të vazhdueshëm. Nga ana tjetër, të intervistuarit që identifikohen si persona queer e vlerësojnë shumë punën e organizatave, duke e parë atë si një hapësirë ku ndihen të përfshirë dhe të mbështetur. Ata theksojnë rëndësinë e programeve të ndryshme që u ofrojnë mundësi për të shprehur veten, si dhe mbështetje në fusha të rëndësishme si shëndeti mendor dhe zhvillimi i shkathtësive të punës. Përmes këtyre programeve, ata kanë përjetuar një ndjenjë përfshirjeje dhe mbështetjeje që është e rëndësishme për fuqizimin e tyre.

Për më shumë, theksi vihet në rëndësinë e shëndetit mendor dhe gjithëpërfshirja e komuniteteve jo-shumicë. Shumica e programeve ofrohen vetëm në gjuhën shqipe, gjë që mund të krijojë pengesa për pjesëtarët e komuniteteve të tjera. Gjithashtu theksohet nevojën për t'i dhënë më shumë fokus adresimit të strukturave politike që ndihmojnë në riprodhimin e shtypjes. Organizatat LGBTI+ kanë arritur të prekin disa nga shtypjet e ndërlidhura që përjetojnë personat queer, duke u ofruar programe që synojnë emancipimin e tyre. Përkundër këtyre arritjeve,

mbetet nevoja për përmirësime në shumë fusha, duke pasur parasysh që, në kontekstin e Kosovës, është sfiduese të luftohen format e ndryshme të shtypjes. Kjo është një çështje që edhe vetë aktivistët e kanë theksuar si një sfidë madhore.

Decentralizimi dhe përfshirja mbetin ndër aspektet më të rëndësishme të përpjekjeve për të zgjeruar aktivitetet përtej Prishtinës, me synimin për të krijuar hapësira të sigurta dhe gjithëpërfshirëse për të personat queer nga zonat rurale. Megjithatë, sfidat janë të dukshme pasi komunitetet queer jashtë kryeqytetit vazhdojnë të përballen me mungesë të mbështetjes dhe infrastrukturës së nevojshme, duke treguar se decentralizimi i vërtetë kërkon burime të qëndrueshme dhe përpjekje afatgjata. Në këtë kontekst, përfshirja e minoriteteve dhe ndryshimi i fokusit drejt çështjeve të strehimit, të drejtave të minoriteteve queer dhe shëndetit mendor pas vitit 2019 reflekton përpjekjet për të adresuar shtypjet e shumëfishta.

Përfshirja e romëve queer dhe grupeve të tjera të marginalizuara përballen me sfida për shkak të barrierave gjuhësore dhe socio-ekonomike, duke theksuar nevojën për programe në gjuhë të ndryshme për të siguruar përfaqësim të plotë. Sfidat e krijimit të hapësirave të sigurta jashtë Prishtinës dhe gjuha homofobike e përdorur nga disa politikanë mbeten pengesa të mëdha, duke krijuar një hendek mes politikave publike dhe realitetit të komunitetit queer. Për të adresuar këtë, kërkohet angazhim i fortë politik dhe shoqëror për të ndërtuar një mjedis më gjithëpërfshirës. Nga ana tjetër, arti dhe kultura luajnë një rol kyç në fuqizimin e komunitetit queer, me iniciativë të ndryshme që përdorin radio, ekspozita dhe trajnime për të rritur vetëdijen dhe për të krijuar platforma për aktivizëm në të drejtat e njeriut. Këto përpjekje reflektojnë rëndësinë e adresimit të çështjeve kulturore dhe sociale krahas atyre ligjore. Në këtë drejtim, mbështetja psiko-sociale mbetet një prioritet i

vazhdueshëm, me organizatat queer që përpiqen të rrisin vetëdijen mbi shëndetin mendor dhe HIV/AIDS. Megjithëse këto përpjekje janë të rëndësishme, ato kërkojnë më shumë burime dhe mbështetje institucionale për të qenë të qëndrueshme dhe efektive.

Kufizimet e Hulumtimit

Ky hulumtim përmban disa kufizime metodologjike dhe strukturore, që ndikojnë në shtrirjen dhe thellësinë e analizës. Për analizën e përmbajtjes janë përdorur vetëm raportet dhe materialet e pesë (5) viteve të fundit, nga dy organizata LGBTI+ në Kosovë, gjë që kufizon diversitetin e strategjive dhe qasjeve të studjuara. Po ashtu, numri i kufizuar i intervistave ngushton mundësinë për përgjithësime mbi komunitetet LGBTI+, ndërsa procesi i rekrutimit u shoqërua me refuzim. Përpjekjet për të përfshirë identitete të tjera të cenuara, se si ata/ato që përballen me racizëm, status të ulët socio-ekonomik apo aftësi të kufizuara, nuk u realizuan plotësisht, përveç një personi që i përkiste një minoriteti gjuhësor dhe me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, përqëndrimi, kryesisht në Prishtinë, kufizon përfaqësimin e përvojave nga zonat rurale dhe më të marginalizuara, duke lënë të paeksploruara disa nga barrierat kryesore, që hasin individët queer në këto zona. Këto kufizime, tregojnë nevojën për një mostër më të gjerë dhe përfshirjen e më shumë organizatave dhe perspektivave, për të ndërtuar një fotografi më të plotë të lëvizjes queer në Kosovë.

Përfundimet

Shoqëria kosovare përballet me sfida të mëdha të dominuara nga normat heteronormative dhe strukturat patriarkale, të cilat vazhdimisht krijojnë dhe mirëmbajnë shtypje. Këto struktura shtypëse, si homofobia, racizmi, dhe mizogjinia kontribuojnë në ruajtjen e status quo-së, duke thelluar pabarazitë shoqërore. Kur një person ka më shumë se një identitet që nuk përputhet me normat dominuese, ai/ajo përjeton shtypje ndërthurëse, ku identitete të tilla si orientimi seksual, përkatësia etnike, mosha ose aftësitë fizike bëhen burime të shumëfishta diskriminimi. Për këtë arsye, është esenciale që organizatat LGBTI+ të avokojnë dhe të marrin parasysh këto dimensione të shtypjeve qasje gjithëpërfshirëse dhe diverse.

Në Kosovë, organizatat LGBTI+ po jetësojnë ndërthurjen në strategjitë, fushata, dhe shërbime duke adresuar shtypjen e shumëfishtë. Megjithatë, lëvizja queer në vend vazhdon të përballet me homofobi në shoqëri dhe institucionet publike. Kjo duhet të ndryshojë emancipimi i komunitetit queer dhe i shoqërisë në përgjithësi për pranimin e identiteteve plurale të ndryshme dhe përfshirjen shoqërore është parakusht për një shoqëri të integruar dhe të drejtë. Krijimi i hapësirave aktiviste për avokim dhe shtypjeve ndërthurëse forcon përpjekjen për drejtësi dhe barazi sociale.

Referencat

Adams, H. (2016). *Intersectionality in queer activism: A Case Study*.
https://scholarworks.bellarmino.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1002&context=ugrad_theses

Butler, J. (1990). *Gender trouble: Feminism and the subversion of identity*. Routledge.

Çakolli, I., & Nokaj, D. (2024). Bërja e historisë queer në Kosovë. *Kosovo 2.0*.
<https://kosovotwopointzero.com/berja-e-historise-queer-ne-kosove/>

Center for Social Group Development – CSGD (2016). *Annual report of Kosovo*. ILGA-Europe Annual Review 2016.

Chiriac, B., Đuković, M., Hadroj, R., Karčić, H., Kouki, E. A., Krasniqi, V., Kyuchukov, H., & Orlović, D. D. (2022). *The Roma Holocaust/Roma genocide in Southeastern Europe: Between oblivion, acknowledgment, and distortion*. The Auschwitz Institute for the Prevention of Genocide and Mass Atrocities.
<https://fxb.harvard.edu/wp-content/uploads/sites/2464/2022/11/The-Roma-Holocaust-Roma-Genocide-in-Southeastern-Europe-Report-1.pdf>

Crenshaw, K. (1989). *Demarginalizing the intersection of race and sex: A Black feminist critique of antidiscrimination*

doctrine, feminist theory, and antiracist politics. University of Chicago Legal Forum.

Cumming-Potvin, W. (2023). LGBTQA+ allies and activism: Past, present and future perspectives. *Continuum Journal of Media & Cultural Studies*, 38(3), 338–352.
<https://doi.org/10.1080/10304312.2023.2296344>

D’Elio, F. (2015). *Intersectionality in LGBTI advocacy.*
<https://www.sexualrightsinitiative.org/sites/default/files/resources/files/2019-04/Intersectionality%20in%20LGBTI%20Advocacy.pdf>

Davis, K., & Zarkov, D. (2017). EJWS retrospective on intersectionality. *European Journal of Women’s Studies*, 24(4), 313–320. <https://doi.org/10.1177/1350506817719393>

Ferber, A. L., Herrera, A. O., & Samuels, D. R. (2007). The Matrix of Oppression and Privilege: Theory and Practice for the New Millennium. *American Behavioral Scientist*, 51(4), 516–531.
<https://doi.org/10.1177/0002764207307740>

Fremlova, L. (2020). *LGBTIQ Roma and queer intersectionalities: The lived experiences of LGBTIQ Roma.* *European Journal of Politics and Gender* 3(3), 371–388.
<https://doi.org/10.1332/251510819X15765046909970>

Limani, L. (2022). From survival to activism: Tracing trans history in Kosovo. In B. Bilić (Ed.), *Transgender in the post-Yugoslav space: Lives, activisms, culture* (pp. 97–133). Bristol University Press.

Puar, J. (2007). *Terrorist assemblages: Homonationalism in*

queer times. Duke University Press.

Rexhepi, P. (2016). *From orientalism to Homonationalism: Queer politics, Islamophobia, and Europeanization in Kosovo*. In B. Bilić (Ed.) *LGBT Activism and Europeanisation in the Post-Yugoslav Space: On the Rainbow Way to Europe* (pp.179–203). Springer Nature.

Robinson, K. R., & Frost, D. (2018). LGBT equality and sexual racism. *Fordham Law*, 8(6), 2739–2754.

https://ir.lawnet.fordham.edu/cgi/viewcontent.cgi?params=/context/flr/article/5518/&path_info=09_Robinson_Frost_2739_2754.pdf

Scheidler TR, Haus KR, Mobley TA, Mark KP. (2022). LGBTQ+ Grassroots Activism: An Opportunity for Resilience. *Journal of Homosexuality*, 70(9):1675–1700. doi:

[10.1080/00918369.2022.2040928](https://doi.org/10.1080/00918369.2022.2040928)

Stanko, J. B. (2021). *Gender analysis of Roma women and girls in VET*.

<https://www.romaeducationfund.org/wp-content/uploads/2021/02/REF-Gender-Analysis-VET-in-Kosovo-May-2021.pdf>

Shtojcat

Pyetësori #1 Për aktivistët e organizatave LGBTI+

Përshëndetje,

Ne jemi Andi Vllasoli dhe Ardea Gojnovci, dy studentë të Universitetit të Prishtinës, Fakulteti Filozofik, dhe, në kuadër të organizatës CEL Kosovo, po realizojmë hulumtim në temën “Lëvizja LGBTI+ në Kosovë dhe për drejtësi sociale”. Me këtë hulumtim, synojmë të shqyrtojmë ndjenjat dhe perceptimet e komuniteteve LGBTI+ në lidhje me përfshirjen dhe reprezentimin në avokim dhe parashtrimin e kërkesave të komuniteteve.

Faleminderit shumë që keni pranuar të jeni pjesë e këtij hulumtimi. Dëshirojmë të theksojmë se çdo informacion që do të ndani do të mbetet konfidencial dhe do të përdoret vetëm për qëllime të hulumtimit.

1. A mund të na jepni një pasqyrë të organizatës suaj në kontekstin e lëvizjes LGBTI+ në Kosovë, duke përfshirë historinë, misionin, fushat kryesore të punës dhe grupet që ju si organizatë synoni?

A mund të na tregoni më shumë për shërbimet specifike që i ofron organizata?

Si i identifikoni nevojat e komuniteteve dhe si siguroheni që programet tuaja t'i përmbushin ato?

2. A mund të ndani më shumë informacion rreth karakteristikave demografike të komuniteteve që shërbeni, dhe si ndikojnë këto karakteristika në punën tuaj?

Ju lutem, a mund të tregoni më shumë për karakteristikat e komuniteteve të moshës, seksualitetit, përkatësisë etnike, klasës, vendndodhjes, aftësisë, religjionit?

3. Cilat gjuhë të tjera përdorni për të arritur tek anëtarët e komuniteteve?

Në çfarë mënyre apo politikë promovoni përfshirjen e njerëzve të ndryshëm brenda komuniteteve (bazuar në vendndodhjen, aftësinë, përkatësinë etnike, moshën, etj.)?

Cilat janë nismat në aktivizëm, avokim ose shërbim që promovojnë përfshirjen brenda komuniteteve LGBTI+

Si e shihni gjithëpërfshirjen në lëvizjet LGTBI+ sot? (Nëse, jo çfarë duhet të bëhet?)

Çfarë bëni për të promovuar përfshirjen e anëtarëve të ndryshëm të komuniteteve në LGBTI+ si organizatë?

5. Cilat janë disa nga sfidat kryesore me të cilat përballeni në punën tuaj, sidomos ato që lidhen me përfshirjen, dhe si i adresoni ato?

Cilat mundësi keni identifikuar për të rritur diversitetin dhe përfshirjen brenda organizatës dhe në komunitet?

6. Si e shihni të ardhmen e organizatës suaj në lidhje me përfshirjen dhe diversitetin?

Faleminderit shumë për kohën dhe informacionin e çmuar që ndatë me ne. Pjesa juaj e puna juaj është jashtëzakonisht e rëndësishme, dhe shpresojmë të vazhdojmë të ndjekim zhvillimet e organizatës suaj. Nëse keni ndonjë burim ose rekomandim për ata që janë të interesuar në punën tuaj, do të ishim të lumtur ta dëgjonim. Faleminderit edhe një herë!

Pyetësi #2 Për pjesëtarë të komuniteteve queer

Përshëndetje,

Ne jemi dy studentë të Universitetit të Prishtinës, Fakulteti Filozofik, dhe, në kuadër të organizatës CEL Kosovo, do të realizojmë një hulumtim lidhur me përvojat, nevojat dhe sfidat e individëve që identifikohen si pjesë e komuniteteve LGBTI+ dhe minoriteteve në Kosovë. Ky hulumtim ka si qëllim të shqyrtojë perspektivat e këtyre individëve mbi drejtësinë sociale dhe përfshirjen.

Faleminderit shumë që keni pranuar të jeni pjesë e kësaj interviste. Dëshirojmë të theksojmë se çdo informacion që do të ndani do të mbetet konfidencial dhe do të përdoret vetëm për qëllime të hulumtimit.

1. A mund të na prezantoni veten?
Cilat janë identitetet e ndryshme që përfaqësoni (p.sh. seksualiteti, etnia, etj.)?
Si kanë ndikuar këto identitete në përvojat tuaja si individ në komunitet?
2. Si e përshkruani angazhimin tuaj me organizatat LGBTI+ dhe çështjet që i trajtoni?
Cila është kohëzgjatja e angazhimit tuaj dhe çfarë ju motivon të jeni aktiv në këtë fushë?
Çfarë nevojash dhe probleme keni identifikuar që ndihmojnë në formësimin e aktivizmit dhe shërbimeve sociale?
Cilat janë sfidat më të mëdha që hasni si individ në këtë komunitet?
A e shihni veten të përfshirë në lëvizjen LGBTI+ dhe në këtë komunitet në përgjithësi?
3. Cilat mundësi shihni për të përmirësuar përfshirjen dhe diversitetin brenda komuniteteve dhe jashtë tij?
Cilat janë iniciativat ose aktivitetet specifik që mendoni se mund të kontribuoni?
Si mund të inkurajoni të tjerë që të angazhohen në promovimin e diversitetit dhe drejtësisë sociale?
4. Si mendoni se mund të përmirësohet ndërgjegjësimi dhe edukimi në lidhje me çështjet LGBTI+ në komunitetin tuaj?
Cilat janë strategjitë më efektive për të arritur tek

individët që nuk janë të njohur me çështjet LGBTI+?

Cilat janë përvojat e juaja me programe edukimi dhe avokimi?

5. Cilat lloje mbështetjeje ose burimesh i konsideroni të domosdoshme për komunitetet LGBTI+?

Si e vlerësoni efektivitetin e shërbimeve ekzistuese të mbështetjes?

A ka ndonjë shërbim që mendoni se mungon dhe që do të ishte i dobishëm për individët në komunitet (shembull: për persona me nevoja të veçanta, të grupeve jo-shumicë, etj.?)

6. Si e imagjinoni të ardhmen e lëvizjes LGBTI+ në lidhje me adresimin për të tjerët në këtë të ardhme?

Cilat janë shpresat dhe pritjet tuaja për zhvillimet në çështjeve, shqetësimeve dhe nevojave të komuniteteve?

Çfarë roli shihni për veten dhe këtë lëvizje?

Faleminderit shumë për kohën dhe informacionin e çmuar që ndatë me ne. Faleminderit shumë që ndatë kohën dhe përvojën tuaj me ne! Ishte vërtetë kënaqësi të dëgjonim historinë dhe perspektivën tuaj. Vlerësojmë gatishmërinë dhe kohën tuaj për pjesëmarrje në intervistë.

Formulari për Pëlqimin e Informuar

Titulli i hulumtimit

Lëvizja LGBTI+ në Kosovë: Qasjet dhe Praktikrat e Ndërthurjes për Drejtësi Sociale

Hulumtuesit

Ardea Gojnovci dhe Andi Vllasolli

Institucioni

Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës

Qëllimet e hulumtimit

Ky hulumtim synon të kuptojë se si Lëvizja LGBTI+ në Kosovë e inkorporon qasjen e ndërthurjes në aktivizëm, avokim dhe shërbimet për individët LGBTI+ dhe si ndjehen komunitetet LGBTI+ për përfshirjen dhe përfaqësimin e tyre në aktivizëm, avokim dhe shërbim.

Çka kërkohet nga ju në hulumtim?

Të bashkëpunoni me hulumtuesit duke iu përgjigjur pyetjeve në bazë të përvojës Tuaj.

Rreziqet dhe Konsideratat

Nuk do të ketë asnjë gjë që do t'iu rrezikon në hulumtim. Megjithatë, disa nga pyetjet mund të nxisin reflektime personale ose të ndjeshme. Jeni të lirë të kaloni çdo pyetje që ju bën të ndiheni të shqetësuar.

Përfitimet nga hulumtimi:

Njohuritë tuaja do të kontribuojnë për një kuptim më të mirë të çështjeve në lidhje me përfshirjen e të gjithë anëtarëve të

komuniteteve LGBTI+ në aktivizmin, avokimin dhe shërbimin e ofruar nga organizatat e lëvizjes LGBTI+ e që mund të përfitojnë nga puna e ardhshme në këtë sferë të rëndësishme shoqërore.

Pjesëmarrja vullnetare

Pjesëmarrja juaj në këtë studim është plotësisht vullnetare dhe këtë mund ta ndërpreni në çdo moment.

Tërheqja nga hulumtimi

Ju nëse doni mund ta ndërpreni pjesëmarrjen në hulumtim në çdo kohë dhe për çfarëdo arsye qoftë. Nëse keni vendosur ta ndërpreni pjesëmarrjen, ose refuzoni t'u përgjigjeni pyetjeve të caktuara, kjo nuk do ta ndryshojë raportin me hulumtuesit.

Konfidencialiteti

Identiteti juaj dhe çdo informacion personal që jepni do të mbahen konfidenciale. Pseudonimet do të përdoren në të gjitha materialet e shkruara ose të publikuara për të mbrojtur privatësinë Tuaj. Regjistrimet audio dhe transkriptimet do të ruhen në mënyrë të sigurtë dhe do të jenë të qasshme vetëm nga hulumtuesit. Pas përfundimit të hulumtimit, regjistrimet audio do të fshihen.

Pyetje lidhur me hulumtimin?

Nëse keni ndonjë pyetje lidhur me hulumtimin në përgjithësi ju mund të na kontaktoni në email apo në numër të telefonit.

I/e intervistuari/a _____